



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË

Data 10.02.2026

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: **Abonim internet ADSL**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Shërbimet e internetit 72400000-4

VLERA E FONDIT LIMIT: **1 055 000 (një milion e pesëdhjetë e pesë mijë) lekë pa tvsh**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Korçë** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10;
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.1.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2022,2023,2024, ku vlera e xhiros për të paktën

një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Ky kriter i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës, prandaj është kërkuar që vlera e xhiros të jete jo më e vogël se 40 % vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin 43 pika 2c dhe nenin 55 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43 pika 1 e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ligjin nr. 29/2023 Për Tatimin mbi të Ardhurat, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje Nenin 61 të ligjit Nr. 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”: 1. Çdo person, që i nënshtrohet këtij ligji, është i detyruar të deklarojë në organin tatimor të gjitha të ardhurat, qofshin ato të tatuara në çfarëdo mënyre apo të përjashtuara nga tatimi. Për personat fizikë që janë nën 18 vjeç deklarata tatimore bëhet nga kujdestari i tyre ligjor. 2. **Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata.**

2.2 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.2.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes të njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

-Per kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë gjithashtu edhe Kontraten e Bashkimit të operatoreve ekonomikë.

-Per kontratat e realizuara si Nënkontraktor, Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë gjithashtu edhe Kontratën baze ndermjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor si dhe Miratimin zyrtar si nenkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55, pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën jo më pak se 20 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre vjetëve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës., që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën jo më pak se 20 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin 55, pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Ne kuader te vleresimit te ofertave ne menyre sa me te drejte, duhet që në rastet e BOE apo Nenkontraktimit, vlerësimi i përvojës të mëparshme të vërtetohet me paraqitjen e kontrates se bashkepunimit apo marreveshjen e nenkontraktimit si dhe me Kontratën bazë dhe aktin e miratimit te nenkontraktimit leshuar nga Institucioni. Dokumenta keto te nevojshme per te vleresuar lidhur me punet konkrete qe ka kryer OE si anetar i BOE,apo si nënkontraktor. Ky dokumentacion disponohet nga çdo OE si në rastin kur ka qene pale në Bashkimin e OE ashtu dhe në rastet kur ka qene Nënkontraktor. Ky dokumentacion është lehtësisht i aksesueshëm dhe është pjesë e dosjes së zbatimit të punimeve të kontratës që duhet ta kete çdo kompani në dosjen e saj, per rrjedhoje nuk mund te sjelle kufizim te pjesmarrjes se OE ne tender as ne menyre direkte dhe as ne menyre indirekte.

2.2.2 Operatori ekonomik duhet të jetë i regjistruar pranë regjistrave të AKEP, për ofrimin e rrjeteve dhe shërbimeve objekt prokurimi dhe të ketë autorizim të Përgjithshëm nga AKEP për transmetim të dhënash.

- Ky kriter plotësohet me dorëzimin e autorizimit të përgjithshëm lëshuar nga AKEP.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, nenit 41/4 e VKM 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, si dhe në zbatim të rregullores së AKEP dhe ligjit nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si Autoritet përgjegjës, organ rregullator, i cili mbikëqyr kuadrin rregullator, të përcaktuar nga ky ligj, nga ligji për shërbimin postar, si dhe nga politikat e zhvillimit të fushës së komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare, të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për ofrimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente.

2.2.3 Operatori ekonomik duhet të disponojë certifikatat e mëposhtme të cilësisë:

- ISO 9001 (Çertifikatë për menaxhimin e cilësisë) ose ekuivalente.

- ISO 27001 (Menaxhimin e Sistemit të Sigurisë së Informacionit) ose ekuivalente.

Çertifikata duhet të jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

* Termi "ekuivalent" përfshin edhe standartet SSH (nese disponohen) të adoptura nga DPA mbi bazën e atyre ndërkombëtare.

* Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave që do të marrë përsipër të realizojë referuar akt-marrëveshjes.

* Në rast se dokumentet e mesipërme janë në gjuhë të huaj ato duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenin 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Standardi ISO 9001 siguron që operatori punon me procedura të strukturuar dhe të audituara, duke garantuar stabilitet dhe performancë gjatë gjithë ciklit të kontratës. ISO 9001 siguron që operatori ka mekanizma të brendshëm për monitorim të cilësisë, për trajtim të shpejtë të problemeve dhe për përdorimin e metodologjisë CAPA për korrigjime dhe masa parandaluese. ISO 27001: Kjo certifikatë garanton që operatori disponon politika dhe kontroll teknik të verifikuar për mbrojtjen e informacionit gjatë transmetimit dhe ruajtjes, duke përfshirë enkriptim, autentifikim të fortë, menaxhim të fjalëkalimeve dhe monitorim të vazhdueshëm të sistemeve. Të dhënat e transmetuara duhet të mbrohen ndaj aksesit të paautorizuar, rrjedhjes së informacionit dhe sulmeve kibernetike.

2.2.4 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një propozim teknik të shoqëruar me skemat e rrjetit të ofertuesit, për zgjidhjen teknike për ofrimin e shërbimit, dorëzimin e skemave përkatëse për të gjitha lidhjet fizike, si dhe përshkrimet për Qendrën e Operacioneve të Rrjetit, strukturën e help-desk-ut dhe shërbimit, dhe strukturën e vetë rrjetit.

- Ky kriter plotësohet me dorëzimin e propozimit teknik

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar në bazë të nenit të 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", të ndryshuar, dhe nenit 41, pika 6 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", të ndryshuar. Paraqitja e një propozimi teknik të detajuar, së bashku me skemat e rrjetit dhe diagramat shoqëruese, është element thelbësor për vlerësimin e kapacitetit të operatorit ekonomik për të realizuar shërbimin e lidhjeve të komunikimit. Kjo kërkesë siguron transparencë teknike, qartësi në mënyrën e implementimit, si dhe mundëson verifikimin paraprak të konstruksionit të rrjetit, konfigurimeve, pajisjeve dhe metodologjisë që operatori do të përdorë. Skemat e rrjetit ndihmojnë autoritetin kontraktor të kuptojë qartë topologjinë e propozuar, rrjedhën e trafikut, pikat e ndërlidhjes, segmentimin e rrjetit dhe arkitekturën e sigurisë, duke garantuar që propozimi përputhet plotësisht me kërkesat teknike dhe standartet e sigurisë të parashikuara.

2.2.5 Operatori ekonomik duhet të zotërojë një infrastrukturë të vetën me fibër optike, ose në rast se operatori nuk disponon një infrastrukturë të vetën me fibër optike për të gjithë pikat e kërkuara në termat e referencës, atëherë operatori duhet të paraqesë çdo dokumentacion të

vlefshëm që vërteton përdorimin e infrastrukturës me fibër optike, me një operator i cili i disponon.

- Ky kriter plotësohet me dorëzimin e çdo dokumentacioni që vërteton përdorimin e infrastrukturës me fibër optike nga O.E

Argumentimi: Ky kriter është përcaktuar referuar ligjit nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Rregullore Nr.47, datë 26.10.2017 “Për zbatimin e regjimit të autorizimit të përgjithshëm”, Rregullore Nr. 22 datë 24.06.2011 “Mbi kushtet teknike për ndertimin e infrastrukturës së rrjeteve kabllorë urbane dhe rrjeteve me fibra optike nderurbane të komunikimeve elektronike”, të ndryshuar, Rregullore Nr. 30, datë 05.12.2013 “Për dhënien e autorizimit individual për përdorimin e frekuencave”.

Ky kriter është kërkuar për tu siguruar që lidhja e internetit që do të ofrohet në pikat e kërkuara në termat e referencës të jetë me fibër optike.

Ky kriter kërkohet për të vërtetuar që Operatori qeradhënës i fibrës optike, ka siguruar të drejtat për ofrimin e rrjeteve ose të shërbimeve të komunikimeve elektronike, nga AKEP.

Kjo kërkesë është thelbësore për garantimin e stabilitetit, sigurisë dhe performancës së lartë të shërbimit që do të ofrohet për institucionin. Fibra optike është teknologjia e vetme që siguron parametra si vonesa të ulëta, shpejtësi të lartë, siguri fizike dhe kapacitet të mjaftueshëm për mbajtjen e trafikut të rrjeteve.

Në rastet kur operatori nuk e zotëron vetë infrastrukturën optike, kërkimi i dokumentacionit zyrtar që vërteton marrëveshjen e përdorimit me një operator tjetër garanton se shërbimi mund të ofrohet pa ndërprerje, me të drejta të plota përdorimi dhe me kontroll të qartë mbi cilësinë e transmetimit. Ky dokumentacion siguron që operatori ka të garantuara të gjitha burimet infrastrukturore të nevojshme, duke eliminuar rrezikun e vonesave, mungesës së mbulimit, konflikteve të aksesit ose kufizimeve teknike gjatë implementimit apo mirëmbajtjes së shërbimit. Përmes kësaj kërkesë, autoriteti kontraktor sigurohet se operatori ekonomik ka një bazë të fortë teknike dhe kontraktuale për të përmbushur detyrimet e projektit, duke garantuar cilësi, siguri dhe vazhdimësi të shërbimit në të gjithë pikat e përfshira.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Fondi limit, afati, termat e references dhe specifikimet teknike janë hartuar nga specialist i fushës i caktuar me urdhrin e Kryetarit të Bashkisë Nr 51 datë 27.01.2026 sipas procesverbalit të mbajtur prej tij.

Specifikimet teknike të shërbimeve objekt prokurimi janë hartuar duke u diktuar nga nevoja për këtë shërbim në kushtet kur kontrata e lidhur në vitin 2025 perfundon me datë 06.03.2026. Specifikimet teknike shprehin tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe në përputhje të plotë me funksionet e kërkuara në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b

dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Specifikimet teknike dhe termat e references të hartuara nga specialist i fushës bëhen pjesë e dokumentave të tenderit.

NJËSIA E PROKURIMIT